



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 29 dhjetor 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1644_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit në ngastrën katastrale Nr. 01130-0, 01131-0 ZK Shupkoc me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Mitrovicës, e pranuar me datë 24.11.2022 nga aplikuesi personi juridik "INTERPLAST GROUP"SH.P.K., me adresë: Komuna e Mitrovicës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 29 dhjetor 2022 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "INTERPLAST GROUP"SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e në ngastrën katastrale Nr. 01130-0, 01131-0 ZK Shupkoc me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Mitrovicës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "INTERPLAST GROUP"SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrik DMI-9026520 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE** do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi** "INTERPLAST GROUP"SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.



Arsyetim

- o ZRRE, me datë 24.11.2022 nga aplikuesi "INTERPLAST GROUP" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit në ngastrën katastrale Nr. 01130-0, 01131-0 ZK Shupkocv me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Mitrovicës.
 - o Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluar, pëlqimin elektroenergetik Nr. 11399 të datës 02.11.2022 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin 08 - 350/02-0084198/2/22 të datës 12.10.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm e Komunës së Mitrovicës.
 - o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "INTERPLAST GROUP" SH.P.K., dhe dëshmive të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike që do të vendosen në kulmin e objektit në kulmin e objektit në ngastrën katastrale Nr. 01130-0, 01131-0 ZK Shupkocv me kapacitet të instaluar prej 40 kW në Komunën e Mitrovicës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Mitrovicës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutrije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar